


KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGIJË DHE I SHËRBIMEVE  
TË UJIT I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



# “Prosumatorët Fotovoltaikë ne Shqipëri dhe në rajon”


**LIRIM SULEJMANI**

Zëvendëskryetar i KRRE-së



## KORNIZA LIGJORE NË MAQEDONINË E VERIUT PËR KONSUMATORËT-PRODHUES - PROSUMATORËT

- Ligji i Energjetikës\* (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 96/18 dhe 96/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 236/22), neni 38 paragrafi (3) pika 2), neni 194-a.
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Ndërtimit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 227/22, neni 4,
- Rregullorja e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 112/19, 240/19 dhe 138/22)
- Rregullat e Furnizimit me Energji Elektrike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 172/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 138/19 dhe 159/22), neni 4
- Rregullat e Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 191/19 dhe 101/22), nenet 68-71.



## LIGJI I ENERGIJETIKËS

➤ **Ligji i Energjetikës\*** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 96/18 neni 38 paragrafi (3) pika 2


- Licencimi – Licencë nuk duhet për:

1. Prodhim të energjisë elektrike për vetëkonsum (me kusht që të mos përdoret rrjeti)
2. Prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme për vetëkonsum, ndërsa teprica e prodhuar e energjisë i jepet sistemit shpërndarës.

➤ **Ligji i Energjetikës\*** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 236/22), neni 194-a

Konsumatorë – prodhues

1. Definohet kategoria – prodhimi i energjisë elektrike të përdoret për vetëkonsum kurse teprica të jepet në rrjetin shpërndarës.
2. Detyrim për furnizuesit për kontratë furnizimi dhe injektim të tepricës së prodhuar në rrjet, mbajtja e evidencës dhe sigurimi i të dhënave për kontratat e nënshkruara.
3. Agjencia e Energjetikës si pikë kontakti për konsumatorët prodhues.



## LIGJI I NDËRTIMIT

- **Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Ndërtimit** (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 227/22 neni 4.


### Lehtësim të procedurës

- Njoftim për vendosje të centralit fotovoltaik deri te autoritetet lokale/komunat – me bashkëngjitje të dokumenteve në vijim:
1. Ekstrakt nga Regjistri Qendror i RMV-së, për persona juridikë/ kopje e letërnjoftimit për personat fizikë
  2. Certifikatë (hipotekë) pronësie për objektin
  3. Projekti kryesorë për vendosjen e centralit
  4. Pëlqim me shkrim për vendosje, në rast se ka më shumë pronarë

### **Centralet fotovoltaike vihen në përdorim mbi bazën e një deklaratë të noterizuar nga kontraktori që i ka instaluar, të dhënë me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, me të cilën konfirmon se:**

1. Centrali fotovoltaik është instaluar sipas projektit kryesorë,
2. Fuqia maksimale e instaluar e centralit fotovoltaik është brenda kufijve të fuqisë së përcaktuar në përputhje me Ligjin e Energjetikës (\*) dhe Rregulloren e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (\*) për këto ndërtesa,
3. Centrali fotovoltaik është i lidhur me infrastrukturën e energjisë elektrike/rrjetin shpërndarës
4. Mund të vihet në përdorim

**Kopje të deklaratës- njësisë së qeverisjes vendore dhe Agjencisë së Energjetikës.**




## RREGULLORJA E BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË

### ➤ **Kush mund të jetë konsumator – prodhues (prosumator)**

1. Konsumatorët familjarë
2. Komuniteti i banesave
3. Konsumatorët e vegjël
4. Shfrytëzuesit buxhetor dhe publik
5. Përdoruesit e vetëm

### ➤ **Konsumatori - prodhues mund ta japë tepricën e energjisë elektrike të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike nëse:**

1. Nuk furnizohet me energji elektrike nga një furnizues i mundësisë së fundit
2. Instalon një sistem fotovoltaiik në një ndërtesë, në të cilën ka të drejtën e pronësisë ose të përdorimit,
3. Kapaciteti i instaluar i impiantit të prodhimit nuk duhet të jetë më shumë se:
  - 6 kW, për konsumtor familjar,
  - 6 kW për një bashkësi të ekonomive familjare
  - 40 kW, për konsumator të vogël, përdorues buxhetor dhe përdorues të vetëm.
4. Injekton tepricën e energjisë elektrike të prodhuar në të njëjtën pikë, në të cilën furnizuesi e furnizon energjinë elektrike.



## RREGULLORJA E BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË


### ➤ Ka dy periudha kontabël:

1. Gjashtë muajt e parë të vitit janë një periudhë kontabël (janar-qershor) dhe
2. Gjashtë muajt e dytë janë një periudhë e dytë kontabël (korrik-dhjetor).

Nëse gjatë një periudhe përlogaritëse, energjia elektrike e injektuar në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike ( $E_p$ ) është më e vogël ose e barabartë me energjinë elektrike të marrë nga rrjeti elektrik i shpërndarjes ( $E_i$ ).



shutterstock.com · 157736174



$C = PCE * 0.9$ , nëse në një periudhë përlogaritëse  $E_i \geq E_p$


**Për shembull:** Çmimi, me të cilin furnizuesi furnizon konsumatorin -prodhues me energji elektrike është 10 denarë/kWh.

Nëse gjatë periudhës përlogaritëse, nga sistemi solar janë injektuar/dhënë 2000 kWh në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, dhe merren nga rrjeti i shpërndarjes 2500 kWh, atëherë çmimi i 2000 kWh të injektuara/dhëna në sistemin e shpërndarjes do të jetë:

$$C = 10 \frac{MKD}{kWh} * 0.9 = 9 \frac{MKD}{kWh}$$

Kjo do të thotë që konsumatori prodhues për periudhën kontabël do të paguajë:


$$2500kWh * 10 \frac{MKD}{kWh} - 2000kWh * 9 \frac{MKD}{kWh} = 25000 MKD - 18000 MKD = 7000 MKD$$



## RREGULLORJA E BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË

### ➤ Rasti i dytë:

Nëse gjatë një periudhe përlogaritëse energjia elektrike e injektuar/dhënë në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike ( $E_p$ ) është më e madhe se sa energjia elektrike e marrë nga rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike ( $E_i$ )




$C = PCE * 0.9 * E_i / E_p$ , nëse në një periudhë përlogaritëse  $E_i < E_p$

**Për shembull:** Çmimi, me të cilin furnizuesi furnizon konsumatorin prodhues me energji elektrike është 10 denarë/kWh. Nëse gjatë periudhës përlogaritëse nga sistemi solar janë injektuar/dhënë 2000 kWh në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, dhe merren nga rrjeti i shpërndarjes 1500 kWh, atëherë çmimi i 2000 kWh të injektuara/dhëna në sistemin e shpërndarjes do të jetë:

$$C = 10 \frac{MKD}{kWh} * 0.9 * \frac{1500 \frac{MKD}{kWh}}{2000 \frac{MKD}{kWh}} = 9 \frac{MKD}{kWh} * 0.75 = \mathbf{6.75 MKD/kWh}$$

$$1500kWh * 10 \frac{MKD}{kWh} - 2000kWh * 6.75 \frac{MKD}{kWh} = 15000 MKD - 13500 MKD = \mathbf{1500 MKD}$$



## RREGULLAT E RRJETIT TË SHPËRNDARJES – procedura dhe kostot e lidhjes ne rrjet

Prosumatori që kërkon të lidhet në rrjetin e shpërndarjes është i detyruar të paraqesë një kërkesë për miratimin e kyçjes në OSSH në formën specifike të kërkesës.

Kërkesa për miratimin e lidhjes duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- Dëshmi pronësie e objektit,
- Projektimi kryesor për centralin gjenerues dhe
- Miratimi për instalim ose leja për ndërtimin e një centrali të lëshuar nga organi kompetent në përputhje me Ligjin për Ndërtim.

OSSH do të lëshojë një miratim për lidhje në rrjetin e shpërndarjes brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës.


OSSH do të dorëzojë një vlerësim për tarifën e kyçjes së bashku me miratimin.

Tarifat e kyçjes përfshijnë vetëm shpenzimet e administrimit për lëshimin e miratimit të lidhjes sipas Çmimeve për shërbime, me kusht që fuqia totale e miratimeve të lëshuara për konsumatorët-prodhues dhe prodhuesit tjerë, për lidhje në rrjetin e shpërndarjes të mos i kalojë vlerat për stacion transformatori të përfshira në tabelën e mëposhtme.

TS MV/LV (kVA)	Total power of generating plants PG (kW)
630	200
400	120
250	80
100	35


Në rast të tejkalimit të vlerës së fuqisë totale të miratimeve të lëshuara për kyçje në rrjetin shpërndarës për stacion transformatori të përcaktuar në tabelë, tarifën e kyçjes do të llogariten në bazë të kostove reale për realizimin e lidhjes.






## **RREGULLAT E FURNIZIMIT ME ENERGIJE ELEKTRIKE**


- Përveç elementeve të detyrueshme të kontratës për furnizim, të përcaktuara në Rregullat e Furnizimit me Energji Elektrike, kontrata nga paragrafi (5) i këtij neni përmban edhe:
  1. Kushtet për injektimin/dhënie të tepërcës së energjisë të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike,
  2. Të dhënat për objektin e prodhimit të energjisë elektrike dhe pajisjet matëse, dhe
  3. Pikën e lidhjes dhe mënyrën e matjes së energjisë elektrike të prodhuar dhe të injektuar/dhënë në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.



➤ KOHËZGJATJA E LIDHJES SË NJË CENTRALI FOTOVOLTAIK NË RRJETIN E SHPËRNDARJES




Gjithsej 71 – 84 ditë



## SHTATOR 2023- PROSUMATORËT, GJENDJA

- Totali i lidhjeve në rrjetin e shpërndarjes: 476
  - Persona juridikë: 223 dhe
  - Konsumator famljarë: 253
- **Kapaciteti total i instaluar: 7.549 kW**
  - Personat juridikë: 6.015 kW dhe
  - Konsumator famljarë : 1.534 kW
- Totali i energjisë elektrike të prodhuar: N/A (energja elektrike e prodhuar dhe e konsumuar nga konsumatorët nuk matet)
- **Totali i energjisë elektrike të injektuar në rrjet: 3.790.135 kWh**
  - Personat juridikë: 3.150.427 kWh dhe
  - Konsumator famljarë : 639.708 kWh.



## MUNDËSIT PËR FINANSIM


### ➤ **Subvencione nga ME përmes një thirrjeje publike**

- Finansim deri 30% ose në vlerë 1000 Eu.

### ➤ **Kredi nga bankat komerciale**

### ➤ **Linjë krediti nga BERZH përmes bankave komerciale**

- 15% Grante vetëm për instalim të sistemit fotovoltaik
- 20% për sistem fotovoltaik edhe ndonjë masë tjetër për efikasitet energjetik.




## ZHVILLIMET DHE SFIDAT E SË ARDHMËS

### ➤ **Aspekti regullativ- Ligji i ri i Eneregetikës**

- Agreguesit
- Komunitete energjetike
- Demand side management/ Menaxhimi me kërkesën e energjisë

### ➤ **Ana teknike**

- Në rajone te caktura të shtetit, mungesë e kushteve teknike për lidhje në rrjetin e shpërndarjes (munges kapaciteti).



# FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!



Lirim Sulejmani  
Zëvendëskryetar i KRRE-së

e-mail: [lirim.sulejmani@erc.org.mk](mailto:lirim.sulejmani@erc.org.mk)

URL: [www.erc.org.mk](http://www.erc.org.mk)